

# CPAS / OCMW

## Si te bëhet një kërkesë për Ndhimë Mjeksore Urgjente (= ndihmë mjeksore për person me qëndrim legal) ?



### Ku duhet ta bëni juve kërkesën për ndihmë Mjeksore Urgjente ?

Juve duhet ti kërkoni Ndhimën Mjeksore Urgjente (= Aide Médicale Urgente en français) CPAS-it të komunës ku juve banoni në mënyrë të zakonshme (= atj ku juve banoni).

CPAS përcakton në frëngjisht një qendër publike të ndihmës sociale. Në gjuhën flamane është OCMW. Në Belgjikë ka një CPAS për çdo komunë. Në rajonin e Brukselit janë 19 komuna.

- ▶ Pa strehë ose pa banesë të përhershme ? Eshtë CPAS-i i komunës ku juve jini më shpesh që është përgjegjës për trajtimin e kërkesës suaj. Në rast dyshimi, të komunës ku juve kini kaluar natën, kërkojini CPAS-it të komunës ku juve kini kaluar natën.
- ▶ Në rast se një CPAS deklarohet 'jo kompetent' dhe refuzon të trajtojë kërkesën tuaj, ai duhet megjithatë t'ju japë një vërtetim se e mori kërkesën tuaj (= provë që ju kini bërë një kërkesë) dhe ti dërgoni kërkesën tuaj CPAS-it 'të mirë' brenda 5 ditëve.



### Kur juve mund të bëni kërkesën tuaj për Ndhimë Mjeksore Urgjente ?

Në se është e mundur, ju duhet të shkoni në CPAS përpara se të kryhen shërbimet mjeksore. CPAS-ët refuzojnë pothuajse gjithmonë të paguajnë faturat mjeksore në rast se ata nuk kanë dhënë pëlqimin e tyre përpara dhënies së shërbimeve !

- ▶ Në rast urgjence ? Paralajmëoni CPAS-in sa më shpejt që të jetë e mundur pasi ju janë kryer shërbimet. Në rast se juve jini shtruar në spital, kërkojini shërbimit social të spitalit që të njoftojë CPAS-in për ju.



### Anketë sociale

Pasi juve kini bërë një kërkesë, CPAS-i duhet t'ju japë një vërtetim se mori kërkesën. Në rast se nuk jua japin, kërkojeni !

Në vazhdim, CPAS-i do t'ju propozojë një takim me një asistant social. Ky takim do të bëhet ose në të njëjtën ditë, ose disa ditë më vonë.

Gjatë këtij takimi, ju mund të shpjegoni situatën tuaj. Asistenti social do t'u bëjë juve disa pyetje dhe, në ndonjë rast, ai mund t'ju kërkojë që të sillni disa dokumenta.

Asistenti social do të duhet gjithashtu t'ju bëjë një vizitë në banesën tuaj.

- ▶ **CPAS-ët normalisht bëjnë gjithmonë një vizitë në banesë, por për kërkesat e ndihmës mjeksore kjo vizitë nuk është e detyrueshme. Në rast se juve nuk mundeni të prisni një asistent social të CPAS-it në banesën tuaj, shpjegojini situatën tuaj asistentit tuaj social.**

Kur anketa sociale ka përfunduar, asistenti social i paraqet raportin e vet një grupi personash të ngarkuar që të marrin vendimet në gjirin e CPAS (= Këshilli ose Komiteti). Është ky grup personash që vendos në se juve kini të drejtën e një Ndihme Mjeksore Urgjente.



## Vendimi i CPAS

CPAS-i merr vendim pas maksimum 30 ditësh nga bërja e kërkesës. Ai në vazhdim, duhet t'ju japë ose t'ju dërgojë shpejt, me anë të një letre rekomande, vendimin e tij zyrtar.

Në rast se kërkesa është pranuar, CPAS-i do të mundësojë që ju të gëzoni të drejtën për shërbime mjeksore dhe, për shëmbull t'ju jape juve :

- › ose një 'réquisitoire' (= një shkresë për një konsultim te një mjek ose ilaçe)
- › ose një 'karte mjeksore' të vlefshme disa ditë, disa javë ose disa muaj, te një mjek dhe/ose një farmaci
- › ose një 'formular identifikimi Mediprima' i cili ju lejon juve të merrni shërbimet mjeksore në një spital

Në rast se kërkesa juaj është refuzuar, juve mund t'i kërkonti këshilla një juristi ose një avokati. Ai do të mundë t'ju këshillojë që të kontaktoni përsëri CPAS-in për reflektim, ose për të bërë një ankesë përpara Gjykatës së Punës (Tribunal du Travail).

- ▶ **Afati për bërjen e ankesës përpara Gjykatës së Punës është 3 muaj !**

Ky dokument u realizuar prej asbl Medimmigrant. Për më shumë informacion lidhur me këtë subjekt, juve mundeni të :



konsultoni sitin tone internet > [www.medimmigrant.be](http://www.medimmigrant.be)



të na drejtoni pyetjet tuaja me anë të e-mailit > [info@medimmigrant.be](mailto:info@medimmigrant.be)



të na merrni në telefon gjatë orareve tona të pritjeve telefonike >

**02/274 14 33 ose 0800/14.960** (n° falas për personat me të ardhura të ulëta ose pa të ardhura)

> hënë **nga ora 10 deri në orën 13** | martë **nga ora 14 deri në orën 18** | enjte **nga ora 10 deri në orën 13** | premte **nga ora 10 deri në orën 13**